

SHARRCEM

a  **TITAN** Group Company

**Përgjegjësia
Shoqërore e
Korporatës dhe
Qëndrueshmëria**
RAPORT 2013

SHARRCEM SH.P.K.

Adem Jashari p.n.

71510 Hani i Elezit

Kosovë

Tel. 00 381 290 385 500

Fax. 00 381 290 385 510

www.sharrcem.com

Personi Kontaktues: Emine Imishti

E-mail: emine.imishti@sharrcem.com



SHARRCEM SH.P.K.


**RAPORT
PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E
KORPORATËS DHE QËNDRUESHMËRIA
2013**

Ky është raporti i dytë i Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës dhe Qëndrueshmërisë që mbulon periudhën prej 1 Janarit deri te 31 Dhjetori i vitit 2013. Raporti përçjell standardet raportuese të Grupit Titan, në përputhje me principet e GRI dhe udhëzimet raportuese të WBCSD/CSI. Të gjitha të dhënat e prezantuara në raport janë përfshier në mostrën e verifikuar në mënyrë të pavarur të kontaktuar në emër të Grupit Titan (shiqo web-faqen www.titan.com Report 2013)

Sharrcem është pronë e SHARR BETEILIGUNGS GmbH në Hamburg, Gjermani, anëtar i Grupit Titan.

Tabela e Përmbajtjes

1. Për Sharrcem	6
Momentet historike	6
2013 shkurtimisht	7
Grupi Titan shkurtimisht	8
2. Mesazh nga Drejtori Menaxhues	10
3. Vlerat e Grupit dhe CSR	11
Organizimi i CSR tek Sharrcem	12
Hisedarët tonë	13
Qëndrueshmëria nëpërmes sistemeve të qertifikuara	18
4. Rrjeti CSR i Kosovës	19
5. Shëndeti dhe Siguria	20
6. Fuqia jonë punëtore	24
7. Zinxhiri furnizues	26
8. Mjedi ynë	28
Linjiti efqient	30
Zhurma e mjedisit	32
Performanca mjedisore	33
9. Investimet	36
10. Komuniteti jonë	38
Rinia	40
Projekti LAB	45
11. Tabela e shpalosjes së GRI	48




Për Sharrcem

Sharrcem është themeluar në vitin 1936 i përbërë nga një furrë vertikale me kapacitet prodhimi prej 4,415 ton në vit. Sharrcem është përvetësuar nga TITAN Group në vitin 2010, përmes procesit të privatizimit në Kosovë. Është fabrika e vetme e çimentos në vend, që gjendet në kufi me Maqedoninë. Në vitin 2010 Sharrcem u bë anëtar i TITAN Group dhe vazhdon të jetë furnizues kryesor i çimentos në Kosovë.






Një vit pas marrjes nga TITAN Group, Sharrcem avancoi dukshëm teknologjinë e vet dhe teknikat për prodhim të lëndës së parë dhe çimentos dhe ka filluar zbatimin e standardeve të larta të integruara në të gjitha nivelet e punës.

Sharrcem është anëtar i:



Sharrcem was certified with:

- ✓ ISO 14001, Sistem për Menaxhim të Mjedisit.
- ✓ OHSAS ISO 18001, për Menaxhim të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.
- ✓ Përveç qertifikimeve Sharrcem ka marrur shpërblime të rëndësishme për iniciativat tona të CSR në 2013. Kompania ja implementuar shpallorjen e emetimeve në web-faqen tonë, sikurse edhe raportimin lokal, të aksidenteve dhe të CSR.
- ✓ Përmirësimi i Automatimit të Proceseve dhe përfshirja e plotë e EAMS (Sistemi për Menaxhim të Aseteve, Enterprize).
- ✓ Së fundi raporti i parë i jashtëm i CSR është publikuar nga Sharrcem në mes të vitit 2013 "Raporti Vjetor i Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës dhe Qëndrueshmërisë 2012", një përkushtim vjetor nga tani.





Në 61 minierat tona ne nxjerrim lëndë të para sikurse gurë gëlqerorë, aljërë, agregate dhe gjips.

Shkurtimisht për Grupin Titan

Titan ofron material ndërtimor për shtëpi, zyre, shkolla dhe projekte të mëdha të infra-structures si autostrada, porte, etj. Kuqiteti i produkteve të Titan, qëndrueshmëria e tyre dhe konstrukcioneve që rezultojnë nga to përfaqësojnë një përgjegjësi të vazhdueshme. Kjo përgjegjësi ndaj shoqërisë e ka shtyer progresin e mundësive teknike dhe intelektuale të Grupit.

Përgjatë historisë 111 vjeçare Titan ju ka përmbytur shumë përgjegjësi tjera. Këto përfshijnë


mirëqenien e punëtorëve të tyre dhe të komuniteteve përreth operacioneve të tyre, suksesin e klientëve të tyre dhe kënaqësinë e akcionarëve. Përbushja e këtyre nevojave të ndryshme ka sjellur ndryshim pozitiv, ka mundësuar aftësitë ripërtitëse dhe sukses të vazhdueshëm. Sot këto përkushtime janë edhe më të rëndësishme. Përderisa mburremi me arritjet tona ne vazhdojmë të përmirësojmë mënyrën si operojmë duke u fokusuar në qështjet më material. Në këtë

Ne kombinojmë çimento, ujë dhe agregate në 127 fabrika tona të betonit. Në 7 fabrika tona ne gjithashtu procesojmë hi fluturues. I cili është i përdorur si përbërës për të bërë çimenton më të dendur, më të fortë dhe më të qëndrueshëm.



Në 15 fabrikat tona të çimentos dhe stacionet blurëse në 9 shtete të ndryshme ne thyejmë, blajmë, ngrohim dhe ftohim lëndë të para për të prodhuar klinker, i cili është pastsaj i përpunuar më tej për të prodhuar çimento.

Grupi Titan
Lokacionet Globale



Kompania Jonë

Grupi Titan konsideron qëndrueshmërinë si një prej qështjeve më të rëndësishme të kohës sonë. Si e tillë grupi ka përfshier praktikën e përgjegjësisë shoqërore dhe të qëndrueshmërisë në operacionet e tyre. Grupi është së afërmi i përzier në iniciativat më të reja të qëndrueshmërisë duke qenë pjesë e WBCSD dhe CSI. Duke marrë pjesë në të gjitha Task Forcat e CSI dhe duke bashkë-kryesuar dy prej tyre grupi ka marrur rol udhëheqës në kontributimin ndaj zhvillimit të praktikave më të reja të prodhimit të qëndrueshëm të çimentos.

Duke vazhduar përkushtimin për të operuar në bazë të Vlerave të Grupit që prej 2010, **qëndrueshmëria mbetet njëra prej komponenteve më të rëndësishme e mënyrës se si Sharrcem punon.**

Si rezultat, në 2013 kompania ka vazhduar të qertifikohet në ISO 18001 (për Shëndet dhe Siguri në Punë) dhe ISO 14001 (për Mjedis) duke demonstruar përkushtim ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, në të njëjtin vit kompania ka marrë draft licencën e IPPC (Licenca e Integruar për Menaxhim dhe Parandalim të Ndotjes), e para e tillë në vend duke vendosur standardin për anëtarët tjerë të sektorit të industrisë së rëndë në Kosovë për të përcjellur.


Duke vazhduar përkushtimin dhe duke siguruar pajtueshmëri të nivelit më të lartë të të gjitha

njësive të biznesit të Grupit Titan kompania ka përfunduar revision të plotë të performancës së iniciativave të përgjegjësisë shoqërore të korporatës dhe qëndrueshmërisë i kryer nga një palë e tretë e pavarur (DNV).

Kompania vazhdon të zhvillojë mënyra të reja të zvoglimit të gjurmës mjedisore dhe rritjes së cultures së sigurisë dhe angazhimit me komunitet.

SHARRCEM

a  TITAN Group Company



World Business Council for Sustainable Development
Cement Sustainability Initiative

Iniciativa për Çimento të Qëndrueshëm (CSI) një angazhim global për prodhues të çimentos, anëtar të WBCSD, duke përfshier operacione në më shumë se 100 shtete në botë është pyka e industries drejtë rritjes së përgjegjeshme dhe të qëndrueshme dhe vendos metodat, praktikën dhe caqet matëse në këtë drejtim.

Taks forcat e CSI:

- TF1: Mbrojtja e Klimës
- TF2: Ko-procesimi
- TF3: Siguria dhe Shëndeti
- TF4: Emetimet e Ajrit
- TF5: Biodiversiteti
- TF6: Komunikimi
- TF8: Qëndrueshmëria e Betonit
- TF9: Uji
- TF10: Zinxhiri Furnizues



wbcscd

Këshilli Botërori Biznesit për Zhvillim të Qëndrueshëm është një organizatë e udhëhequr nga Oficerët Ekzekutiv (Drejtorët) nga kompanitë progressive që nxitë komunitetin botëror të biznesit të krijojë një ardhmëri të qëndrueshme për biznes, shoqëri dhe mjedis.

Mesazh nga Drejtori Menaxhues

Të nderuar hisedarë,

Është kënaqësi e madhe për mua të prezantoj, në emër të të gjithë punëtorëve tanë raportin e dytë vjetor të CSR, duke krijuar standard, dhe shpresojmë trashëgim, që lidhë kompaninë, hisedarët e saj dhe shoqërinë përmes shpalosjes dhe komunikimit transparent. E fundit, ne konsiderojmë në Sharrcem, është 'conditio sine-qua-non' për rritje të qëndrueshme dhe sjellje të përgjegjshme.



Ne kemi të lumtur të themi se në 2013 Sharrcem ka pasur mundësi të materializojë një numër të qertikmeve prioritare duke tejkaluar kërkesat rregullative, mirëpo, që janë të rëndësishme pasi që janë mënyrë se si ne e kryejmë punën tone. Në këtë respect Sharrcem është qertifikuar me ISO 14001 OHSAS për Shëndet dhe Siguri në Punë si dhe ISO 18001 EMS për Menaxhim të Mjedisit. Ne kemi marrë edhe një hap të rëndësishëm përpara duke inalizuar aplikimin tone për IPPC në bashkëpunim të përafërt me autoritetet e vendit. Kjo, pa asnjë dyshim, do të bën kompaninë të gatshme për të marrur, herët në 2014, lejen e plotë për parandalim dhe kontrollim të integruar të ndotjes (IPPC), e cila është standard i industries për shtete të zhvilluara.

Gjëndja e ekonomisë në rajonin tone nuk ishte aq e mire në vitin e kaluar. Shtetet fqinje ballafaqohen me tregje tkurrëse dhe stagnim afatgjatë të sektorit të ndërtimtëtarisë, përderisa Kosova ende duhet të vazhdojë të ballafaqohet me papunësi dhe varfëri të lartë si edhe me nivele të ulëta të investimeve ndërkombëtare

dhe locale. Nën këto rrethana përgjegjësia shoqërore mbanë rëndësi të lartë për të gjithë qytetarët.


Edhe pse ne jemi të nderuar që kemi fituar qmime për CSR në Kosovë si edhe në Evropë, ne nuk kemi zvogëluar angazhimet tona të përgjegjësisë shoqërore aspak. Në të kundërtën kompania është angazhuar në një projekt të madh dhe afatgjatë për të krijuar Ndërmarrje të Reja të Vogla dhe të Mesme dhe përmes tyre punësim që ne besojmë mund të jetë model për komunitete tjera në nevojë. Komiteti CSR i Sharrcem është angazhuar për të krijuar diçka të re, prapë, në vend duke përvetësuar dhe filluar të implementuar udhëzimet dhe metodat e WBCSD/CSI. Në të vërtetë kanë prezantuar planin për 2014 i cili përfshien sigurinë në transport, menaxhment të ujit dhe biodiversitetit, përfshirje sociale, menaxhment të rrezikut, të gjitha këto qëhstje jetike për industrinë. Në 2013 kompania ka investuar dhe vendosur në vend të gjitha sistemet e kërkuara, në automatim të procesit dhe apli-

kacion për menaxhim të aseteve (EAM) për të mundësuar përkrahjen e këtyre iniciativave.

Në këtë raport, i cili është revizuar nga DNV – GL (Det Norske Veritas – Germaniche Loyd) dhe i integruar në raportin CSR të Grupit Titan ju do të mund të gjeni gjurmën e plotë CSR të kompanisë sonë, në sekcione: Njerëzit Tanë, Zinxhiri Furnizues dhe Mjedisit dhe Komuniteti. Ne besojmë që këto informata hapin rrugën për komunikim transparent dhe angazhim efikjent dhe ne i mirëpresim të gjitha komentet dhe propozimet.

Shpresoj që ta gjeni këtë raport të dobishëm dhe ftoj të gjithë lexuesit për propozimet e tyre. Me këtë të fundit do të dëshmojmë që ky raport e ka shërbyer qëllimin e tij.

Sinqerisht,



Emmanuel Mitsou,
Drejtor Menaxhues

Vlerat Tona dhe Politikat e CSR

Përgjegjësia Shoqërore e Korporatës

- Siguria së pari
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Angazhimi me hisedarë

Përmirësimi i vazhdueshëm

- Organizatë që meson
- Gatishmëria për ndryshim
- Ballafaqimi me sfida

Integriteti

- Praktika etike të biznesit
- Transparenca
- Komunikimi i hapur

Vlera për klientët

- Parapritja e nevojave të klientëve
- Zgjidhje inovative
- Produkte dhe shërbime të kualitetit të lartë

Dijenija (Know-how)

- Rritja e bazës sonë të dijenisë
- Aftësia në secilin funksion
- Ekselencia në kompetencat kryesore

Përkushtimi ndaj rezultateve

- Vlera për akcionarë
- Objektive të qarta
- Standarde të larta

“ Grupi Titan ka për qëllim të rritet si një prodhues multi-rajonal i integruar në mënyrë vertikale duke kombinuar shpirtin ndërmarrës dhe ekselencën operacionale me respekt për njerëz, shoqër dhe mjedis ”



Politika e CSR e Grupit Titan

“Për të ndjekur gjithmonë synimet tona të biznesit dhe në krijimin e vlerave, në mënyrë etike dhe me përgjegjësi sociale, duke bërë më pak dëm dhe duke u përpjekur për të bërë më shumë mirë”

Për të arritur vizionin tonë

- Praktika jonë e biznesit udhëhiqet dhe bazohet në Vlerat tona Titan dhe në kodin tonë të mirësjelljes.
- Siguria është prioriteti ynë më i lartë në biznes me qëllim të arritjes së një mjedisi të lirë nga aksidentet dhe incidentet.
- Jemi të zotuar për një rritje të qëndrueshme, integrimin elementeve njerëzore, mjedisore dhe shoqërore në

vendimet tona të biznesit.

- Ne synojmë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës sonë sociale, matjen e ndikimit dhe kontributeve të vlerësimit e ndikimit tonë mjedisor dhe shoqëror.
- Synojmë në ndërtimin e besimit me të gjithë hisedarët tanë duke komunikuar hapur dhe në mënyrë transparente, dhe duke kërkuar angazhim për të kuptuar ndikimin e operimeve tona dhe shqetësimet e tyre.
- Ne ndajmë përvojën tonë, dijen dhe praktikën më të mira në fushat relevante të biznesit tonë për t'i shtuar vlerën dhe kontributin për mirëqenien e komuniteteve tona fqinje.
- Ne vlerësojmë punëtorët tanë dhe u

përmbahemi praktikave të burimeve njerëzore që promovojnë mundësi të barabarta në rekrutim, punësim dhe zhvillim, pa marrë parasysh gjininë, origjinën etnike, fenë etj. Duke respektuar individualitetin dhe duke qenë në pajtim me ligjet nacionale dhe udhëzimet ndërkombëtare në mënyrë vullnetare, siç është Deklarata Universale e KB-së për të Drejtat e Njeriut.

- Ne merremi me zinxhirin tonë të furnizimit në përputhje me Kodin e Sjelljes së Prokurimit të Grupit tonë dhe atë Regjional.
- Në mënyrë vullnetare angazhohemi dhe mbështesim partneritetet dhe rrjetet e biznesit që promovojnë synimet tona të biznesit dhe vizionin e CSR, siç



janë KB Global Compact, WBCSD/CSI, Aleanca e BE-së për CSR, Iniciativa e SHBA-ve e Përbashkët për Qëndrueshmëri të Betonit etj.

- Ne synojmë të jemi aktiv në përpjekjet qytetare dhe në procesin e avancimit të përdorimit të produkteve tona dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë afatgjatë dhe prosperitetin ekonomik të industrisë sonë.
- Ne inkurajojmë dhe njohim iniciativën individuale dhe vullnetarizmin në komunitet dhe aktivitetet qytetare në të gjitha nivelet e punëtorëve, që ndërlidhen apo jo me biznesin tonë.
- Jemi të zotuar që të sigurojmë ofrimin e raporteve tona të praktikave të CSR në mënyrë periodike.


Duke u inspiruar nga tradita kodit të sjelljes së CSR të Grupit Titan, Sharrcem, si kompani e Grupit, punon me zell në implementimin e projekteve dhe proceseve të brendshme dhe të jashtme për përmirësimin e performancës së CSR dhe gjurmës shoqërore. Në këtë aspekt shumica e provave të kompanisë janë të drejtuara drejtë mbrojtjes së mjedisit, krijimit të një kulture të sigurisë dhe të një shoqërie më të shëndoshë, si dhe krijimin e punësimit (shiko faqen 20).

Përkushtimi në Organizatë

Përkushtimi i Sharrcem ndaj CSR nuk aplikohet vetëm nga menaxhmenti senior mirëpo përfshien angazhim dhe kontribut nga të gjithë punëtorët e kompanisë. Në mënyrë që secili zë të dëgjohet dhe të gjithë të përfshihen në vendim-marrje, kompania zhvillon të gjitha aktivitetet e CSR nën udhëheqësinë e Komitetit të CSR dhe Task forcës së CSR të cilat janë të përbëra prej punëtorëve nga të gjitha pozitat dhe nivelet e organizatës.



Pjesëmarrja në Organizatë:



Caqet dhe Prioritetet Kryesore Tona

Edhe pse ne mburremi me aktivitetet tona deri tani, në Sharrcem ne mbesim të fokusuar në përgjigje me prioritet ndaj çështjeve materiale për komunitetin tone. Në këtë drejtim ne mirëmbajmë me vigjilencë listën e hisedarëve tanë dhe një komunikim të vazhdueshëm me të njëjtit, një detyrë jetike e Task Forcës sonë për CSR, që të planifikojmë në mënyrë të duhur. Në të njëjtën kohë ne mundohemi të përmirësojmë organizatën tonë përmes implementimit të sistemeve të certifikuara që mundësojnë përcjelljen dhe raportimin e performancës së qëndrueshmërisë.

Hisedarët Tanë

“Ne kemi për qëllim të ndërtojmë besim me të gjithë hisedarët tanë duke komunikuar në mënyrë të hapur dhe transparente dhe duke kërkuar angazhim për të kuptuar ndikimin e operacioneve tona dhe brengave të tyre”

Ne dëgjojmë dhe i përgjigjemi hisedarëve tanë dhe gjithmonë mundohemi të sigurojmë që qasjet tona janë të dizajnuara për të i përmbushur nevojat dhe interesat e tyre. Ne besojmë që vetëm duke marrë reagim inkurajues nga ata mund të konsiderojmë një punë CSR të kryer mirë. Duke kuptuar rolin tonë si një qytetar tjetër në komunitetin tone, Komiteti për CSR i Sharrcem ka themeluar Task Forcën për CSR që do të shërbejë si një antenë që do të pranojë sinjalet e shoqërisë nga niveli lokal si dhe nacional. Ata mbasin në komunikim të vazhdueshëm me hisedarët duke analizuar çështjet nga rëndësia dhe relevanca dhe përfundimisht i prezantojnë të dhënat e tyre para Komitetit për CSR. Task Forca është e kompozuar në mënyrë adekuate dhe e gatshme për të mishëruar vendimet e Komitetit. E fundit, e udhëhequr nga një menaxher-qytetar lokal dhe e furnizuar me një buxhet të dedikuar punon nën statute zyrtare operacionale që i'a mundëson marrjen e


vendimeve detyruese përfundimtare.

Edhe pse ne po veprojmë në një vend dhe treg në zhvillim ne kërkojmë sa më shumë propozime dhe bashkëpunim prej vendit në mënyrë që të balancojmë në mënyrë të vazhdueshme ndikimin e operacioneve tona dhe të sigurojmë që jemi të rreshtuar si duhet me standardet e Grupit si dhe përkushtimeve ndërkombëtare.

Si pjesë kyçe e rregullave për angazhim të CSR ne kemi kryer një identifikim të detajuar të hisedarëve tanë lokal dhe nacional prej kategorive të mëposhtme:

- **Punëtorët**
- **Zinxhiri Furnizues (klientët, furnitorët, kontraktuesit)**
- **Komunitetet Lokale**
- **Qeveria**
- **Institucionet Financiare**
- **Institucionet Ndërkombëtare**
- **Organizatat Jo-Qeveritare**
- **Akademia**
- **Shoqatat për Industri dhe Tregti**

Sharrcem ka organizuar një seri takimesh me Bordin e Pavarur Lokal. Gjatë këtyre takimeve njëzet e pesë (25) propozime të ndryshme janë zbatuar në fushat e përkrahjes për komunitet, sport, aktivitete kulturore dhe atletike, përkrahje për arsim, donacione filantropike, etj. Bordi i Pavarur Lokal (BPL) ka shërbyer si një instrument i shkëlqyeshëm për komunikim në 2013 dhe vazhdon në të njëjtën frymë.



Prioritetet Kyçe

- Angazhim i vazhdueshëm me hisedarë kyç: Shpalosje dhe transparencë.
- Fokus në çështje material për komunitet
- Fuqizimi i mëtejshëm i Bordit të Pavarur Lokal
- Implementimi i projektit LAB (Laboratori për Aktivitete të Biznesit)
- Trajtimi i ujërave të zeza
- Trajtime dhe përmirësim i vazhdueshëm
- Zhvillim i punëtorëve, trajnime për shkathtësi dhe kulturë sigurie
- Përkrahje dhe kontribut për Rrjetin CSR të Kosovës
- Plotësim i standardeve të larta të qëndrueshmërisë përmes Sistemeve të Certifikuara
- Ngritje e vazhdueshme e vetëdijes së CSR në kompani, komunitet dhe më tej
- Marrja e licencës IPPC si dhe përdorimi i karburanteve alternative
- Rreshtimi me SA-8000

Angazhimi me Hisedarë

Fabrika e çimentos Sharrcem në Han të Elezit vazhdon të bën investime të të cilave përfitues kryesorë janë pikë së pari qytetarët. Kjo fabrikë ka ndarë një buxhet substancial për Laboratorin për Aktivitete të Biznesit (LAB) duke mundësuar krijimin e Ndërmarrjeve të Reja të Vogla dhe të Mesme në sektorin e bujqësisë.

Sharrcem ka prezantuar projektin LAB, më i madhi i kësaj natyre në Kosovë, përpara një numri të madh të qytetarëve të Hanit të Elezit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i vendeve të reja të punës për banorët e Hanit të Elezit, përmes krijimit të ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme. Bujqësia është identifikuar si sektori kryesor për investime.

Gjatë prezantimit të projektit menaxheri i prodhimit, Z. Enver Curri, deklaroi që ky projekt do të dëshmojë të jetë i dobishëm për komunitet. "Kompania është gjithmonë e përkushtuar ndaj komunitetit ku vepron. Përmes Laboratorit Për Aktivitete të Biznesit ndërmarrje të reja do të krijohen të cilat në anën tjetër do të krijojnë

vende të reja të punës".

Duke ju drejtuar qytetarëve, Drejtori Menaxhues i kompanisë, Z. Emmanuel Mitsou, i siguroi ata që projekti LAB do të vazhdojë të ketë përkrahjen e Sharrcem. "Edhe nëse nuk do të ketë fonde tjera ne do të vazhdojmë të përkrahim projektin. Faza e parë e parë e këtij projekti ka parë një gjysmë milioni euro të ndara për të. Unë jam i sigurt që bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Bujqësisë dhe hisedarë tjerë do të bëjnë projektin edhe më të suksesshëm" tha Z. Mitsou.

Në anën tjetër këshilltari politik i Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Z. Halit Hoxhaj, nënvizoi që Ministria ka një bashkëpunim të thellë me këtë projekt dhe që përkrahë thellësisht këtë iniciativë. "Ky projekt do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të komunës dhe do të krijojë biznese të qëndrueshme. Kjo nuk është një lëmshë, mirëpo një shtytje që krijon vende të integruara të punës përmes LAB-it" përsëriti Z. Hoxhaj në fjalimin e tij.

Në takim ishte prezent edhe Z. Evangelos Vergos, prej Shkollës Amerikane për Bujqësi (American Farming School) në Selanik të cilët janë angazhuar si Këshilltar Shkencor i projektit. Në fjalimin e tij për qytetarët ai dha shembuj



konkret për mënyrat se si të sigurohet suksesi i projektit, sidomos kur janë në fjalë ndërmarrjet e reja. Z. Vergos nënvizoi që rezultate pozitive mund të arrihen vetëm përmes bashkëpunimit.

Shumë qytetar që ishin prezent në forum mirëpritën këtë projekt dhe shfaqën interesimin e tyre për pjesëmarrje në çka do që shpien drejtë një komuniteti më të mirë në tërësi. Laboratori për Aktivitete të Biznesit (LAB) është nisur direkt për përkrahjen e ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme për të krijuar vende të reja të punës dhe për të zvogëluar varfërinë. Siç është cekur edhe më parë projekti do të fokusohet në krijimin dhe përkrahjen e ndërmarrjeve në fushën e bujqësisë dhe agro-biznesit. (lexo më shumë për projekt në faqen 45, 46, 47)

Forumi i Parë me Hisedarë në Han të Elezit

Me 28 Tetor, Sharrcem ka organizuar një ndodhi për hisedar lokal, i mbajtur nga Kryesuesi i Komitetit për CSR, Z. Enver Curri, i përkrahur nga anëtarët e Task Forcës për CSR.

Ndodhia është organizuar në Qendrën e Kulturës së Komunës dhe është vizituar nga Kryetari i Komunës, Z. Refki Suma dhe zyrtarë tjerë të lartë të komunës si dhe qytetarë të tjerë. Task Forca për CSR e Sharrcem prezantoi raportin e kompanisë për CSR të vitit 2012 dhe aktivitetet e vitit 2013 deri në atë datë,

ndërsa Drejtori Menaxhues i kompanisë dha një pasqyrë në planet e ardhme dhe identifikoi prioritetet për kontribut shoqëror.

Bazuar në porositë e Kryesuesit të Komitetit për CSR që kjo ndodhi ka për qëllim të vendos transparencë përmes shpalosjes fjala ju dha qytetarëve dhe një shkëmbim i frytshëm idesh dhe informatave ndodhi. Ishte hera e parë që një ndodhi e tillë ka ndodhur në komunitet dhe ne e konsiderojmë si të suksesshme si rezultat i pjesëmarrjes së gjerë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.

Vetë përmirësimi i Vazhdueshëm – Punishte e Brendshme

Në Sharrcem ne konsiderojmë si esencial vetëdijesimin për angazhim shoqëror në të gjithë organizatën tonë.

Me ndihmë nga Grupi, një punishte dy ditore rajonale me emrin "Mësimi, Angazhimi, Përmirësimi" i udhëhequr nga Drejtori Korporativ për CSR, Znj. Maria Alexiou dhe i paraqitur para një audience që mbulonte disa departamente të organizatës.





Sharrcem shpërblehet me Çmimin Evropian për CSR për iniciativën e tyre BPL

“Në Tetor të 2011 Komisioni Evropian publikoi një komunikatë të re mbi Përgjegjësinë Shoqërore të Korporatës, apo CSR. Aty definon CSR si ‘përgjegjësia e ndërmarrjeve për ndikimin e tyre në shoqëri’. Nga pikëpamja e Komisionit një qasje strategjike dhe e koordinuar ndaj CSR është duke u bërë shumë e rëndësishme për konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve dhe zhvillimi i CSR duhet të udhëhiqet nga vetë ndërmarrjet. Për të rritur pamjen e aktiviteteve të suksesshme të CSR dhe për të shpërndarë praktikatat e mira, Komisioni në bashkëpunim me CSR Europe dhe Biznesin në Komunitet nga Mbretëria e Bashkuar ka Filluar Çmimin Evropian për CSR për të shpërblyer partneritete të mira në mes të ndërmarrjeve dhe hisedarëve tjerë. Objektivi kryesor i Skemës për Çmimin

Evropian për CSR është rritja e dukshmërisë së praktikave të shkëlqyeshme në fushën e CSR dhe të ndajë praktika të tilla nëpërmes Bashkimit Evropian duke inkurajuar më shumë ndërmarrje të vazhdojnë këta shembuj dhe të bashkëpunojnë me hisedarë për t'i përmbushur më mirë përgjegjësitë e tyre shoqërore. Si rezultat ky “Gulden Bosk” apo Libër i Artë është një përmbledhje e dijenisë dhe një burim i mirë i inspirimit. Shpresoj që do të shërbejë si një burim i pasur i praktikave të mira dhe të inkurajojë partneritete të shumta të CSR nëpërmes ndërmarrjeve dhe hisedarëve të tyre.”

Antonio Tajani

Nën-Kryetar i Komisionit Evropian

European CSR Award Scheme

Inspiring partnerships for innovation and impact

Co-led by



Supported by



Organized by



First European CSR Awards Projects 2013

**WINNING PARTNERSHIP IN THE LARGE COMPANY CATEGORY:
INDEPENDENT LOCAL ADVISORY BOARD**

SHARRCEM

a **TITAN** Group Company



Takimet me Hisedarë

Sharrcem ka organizuar takime të shumta me Rrjetin CSR të Kosovës në përkrahje të aktiviteteve të rrjetit. Si anëtar i Bordit të Drejtorëve të Rrjetit Sharrcem mori pjesë në 8 takime gjatë vitit 2013. Në përgatitje për projektin e tyre kryesor të CSR të vitit 2014 për krijim të ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme në komunitetin ku veprojnë Sharrcem ka mbajtur takime me një numër të OJQ'vë të rëndësishme në vitin 2013. Takimet u mbajtën me organizatat që vijnë:

1. **HELVETAS – Swiss Intercooperation**
2. **NOAKOS – New Opportunities for Agriculture in Kosovo**
3. **USAID**
4. **KFOS – Kosovo Foundation for Open Society**
5. **UNDP**
6. **World Bank**
7. **IFC – International Finance Co.**
8. **EBRD – European Bank for Reconstruction and Development**
9. **GIZ– German Society for International Cooperation**
10. **KfW – German Cooperation**
11. **SDC – Swiss Cooperation**
12. **ADA – Austrian Development Agency**
13. **DANIDA – Danish International Development Agency**
14. **Kosovo CSR Network**
15. **ICK – Innovation Centre Kosovo**

Ndërtimi i konsensusit me hisedarët kyç

Në mjedisin tonë të vështirë që është Kosova, një treg në zhvillim, nevoja për vendosjen e principeve të qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë shoqërore brenda përkushtimeve, publi-

ku, autoritetet dhe rrjeti shoqëror bëhet më i saktë. Sharrcem është qytetar pjesëmarrës duke synuar kontribut në procesin e evolucionit në vendit në nivelet më të larta.

Në vitin 2013 Sharrcem ka marrë pjesë aktivisht në ndodhi të ndryshme me rëndësi të madhe.



Përgjegjësia e Sektorit të Industrisë së Rëndë ndaj Mjedisit / Organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane dhe koordinuar nga Sharrcem

Ndodhia, e përkrahur nga Sharrcem, ishte lidhur me iniciativën e përbashkët të Sharrcem dhe Oda Ekonomike Amerikane për të krijuar një grup lokal të industrisë me detyrë për të formuar një trup kompetent këshillues që do të përcjellë përvojën e tij duke u bazuar në praktikatat më të reja ndërkombëtare drejtë Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.

Takimi i Investitorëve të Bashkimit Evropian / Organizuar nga zyra e BE në Prishtinë në Prishtinë

Krijimi i një Asociacioni të Bizneseve Evropiane me tri qëllime kryesore: (1) avokim – në mënyrë për të zgjidhur pengesat ligjore dhe administrative, (2) fuqizimi i ligjit dhe (3) përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes në vend në mënyrë që të shtohet kapaciteti për tërhiqje të investime të huaja të reja.

Bashkëpunimi i përafërt me Bashkim Evropian dhe rreshtim të vazhdueshëm në përputhje me Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim dhe procesin e saj monitorues.



Përkrahje për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në lidhje me Mjedis dhe Ndryshim të Klimës / UNDP

Sharrcem ka marrë pjesë përmes Menaxherit të Mjedisit në kapacitet të konsulentit kombëtar për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të Adaptimit të Kosovës.

Si kontribut në ndërtimin e kapaciteteve dhe rreshtimin me strategjitë mesatare dhe afatgjata, ekipi shkencor është bashkuar për të ofruar përkrahje për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë.



Klima e Biznesit në Kosovë / Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Thulumtimi i bizneseve të Evropës Jug-Lindore kryhet çdo vit nga Odat Ekonomike Gjermane (AHK) te rajonit të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL). Të dhënat e këtyre hulumtimeve pastaj prezantohen në nivelin ndërkombëtar si një masë e rëndësishme për vlerësimin e zonës ekonomike të Evropës Jug-Lindore. Si rezultat i pjesëmarrjes së 16 odave të ndryshme nga 16 shtete ne kemi pranuar informata nga 1,623 kompani të ndryshme, prej të cilave 31 kanë qenë nga Kosova.

Pas kompletimit të hulumtimit Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ka prezantuar rezultatet në një konferencë shtypi.



Konferenca e shtypit ka qenë e vizituar nga përfaqësues të Ambasadës Gjermane në Kosovë si dhe partnerë të ndryshëm siç janë odat tjera ekonomike, biznese të ndryshme, etj.



Konferenca Ndërkombëtare për Ekonominë e Arsimit në Kosovë / GIZ-German Cooperation

Konferenca e fokusuar në sistemin e arsimit në Kosovë me qëllim për identifikim të nevojave për adaptim që mund të shërbejnë si udhë rrëfyese për politikë-bërje. Qëllimi i konferencës ishte të zhvillohen një numër i rekomandimeve për Kosovë me një pjesëmarrje të fortë të të gjithë hisedarëve prej politikës, ekonomisë, sektorit të arsimit, akademisë, medieve dhe shoqërisë civile. Sharrcem ka marrë pjesë si përfaqësues të industrisë në tryezën e rumbullakët "Mbi nevojat e tregut të punës dhe përgjegjësi-ve të biznesit ndaj kualitetit të arsimit" dhe kanë shfaqur përvojën e tyre.



Ngritja e Vetëdijesimit për CSR / Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Rrjeti CSR i Kosovës

Rrjeti CSR i Kosovës me bashkëpunimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Odës Ekonomike Amerikane kanë organizuar ndodhinë "CSR – Një Investim i Mençur që Siguron Përparësi për Biznesin e Juaj".

Në këtë ndodhi, Z. Robert Wright, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Rrjetit CSR të Kosovës dhe Drejtori Gjeneral i Bankës Raiffeisen Kosovo ka prezantuar arritjet e Rrjetit CSR të Kosovës.

Ai ka theksuar që "janë zbatuar projekte të shumta të CSR nga anëtarët tanë gjatë dy viteve të kaluara dhe që tash mund të themi se rrjeti është duke u forcuar dhe duke pasur ndikim pozitiv në biznes dhe mjediset shoqërore në Kosovë. Mirëpo ende ka punë para se të themi që Kosova me të vërtetë përfaqëson CSR-in". Z. Wright shtoi që duhet të thuhet se Rrjeti CSR i Kosovës nuk mundet vetë të bëjë gjërat që janë të nevojshme që CSR të jetë realisht efektiv në Kosovë dhe për të bërë ndryshime të dukshme. Qeveria e Kosovës, komuniteti i bizneseve dhe hisedarët tjerë duhet të marrin pronësi në caqet tona dhe të kontribuojnë në zhvillimin e iniciativave të tyre personale. "Ju na nevojiteni neve, ndërsa juve ju nevojitet CSR" përfundoi Z. Wright.



Certifikimet

Përkushtimi i jonë ndaj përmirësimit të vazhdueshëm është i reflektuar në integrimin e shpejtë dhe të plotë sistemeve ndërkombëtare të menaxhimit. Certifikimi për ISO 0119 u arrit si hap i parë në vitin 2011.

Së shpejti pastaj, në Nëntor të vitit 2013, Sharrcem ka siguruar certifikatën për menaxhim të mjedisit nga Kompania Evropiane për Inspektim dhe Certifikim.

Kjo certifikatë është lëshuar në përputhje me standardin “EN ISO 14001: 2004” dhe është e vlefshme në fushat e prodhimit të çimentos dhe mihjes.

Përmes kësaj certifikate përkushtimi i Sharrcem ndaj mbrojtjes së mjedisit është i nënvizuar

edhe më tej duke e vlerësuar mënyrën se si i kryejmë aktivitetet tona në përputhje me standardet më të larta ekologjike.

Në Dhjetor të 2013 Sharrcem është certifikuar edhe me Sistemin Menaxhues për Siguri dhe Shëndet në Punë, në përputhje me standardin BS OHSAS 18001:2007 dhe është i vlefshëm në fushat e prodhimit të çimentos dhe mihjes.

Vlerësimi me këtë certifikatë ka ngritur edhe më shumë kontributin e Sharrcem duke marrë parasysh që shëndeti dhe siguria e punëtorëve është me rëndësi të madhe për Sharrcem dhe që fabrika synon të krijojë një mjedis të shëndosh dhe të sigurt të punës.

Menaxhmenti i Sharrcem vazhdon të jetë i vetëdijshëm për mundin e vazhdueshëm që duhet të dedikohet në përmirësimin e kulturës së

sigurisë por gjithashtu zgjatjen e kësaj kulture tek kontraktuesit dhe furnitorët e kompanisë.

“Me këtë certifikim investimet gjithëpërfshirëse të kompanisë janë vlerësuar që janë ngritur prej përkushtimit tonë për mbrojtje të mjedisit. Duhet të theksohet që mbrojtja e mjedisit është njëra prej shtyllave kryesore dhe qëllimeve kyçe të kompanisë, dhe si e tillë Sharrcem do të vazhdojë të modernizojë procesin e prodhimit, i cili do të përmirësojë aktivitetet tona me ndikim në mjedis.” Halil Berisha, Menaxher për Mjedis, Sharrcem



ITEM	MGT SYSTEM / CERTIFICATION		STATUS
TË GJITHA PRODUKTET / LLOJET E ÇIMENTOS	CEM IV/B (P-W) 32.5R	} EN 197-1: 2000	✓
	CEM II/B-M (W-L) 42.5R		✓
	CEM I 52.5N		✓
	MC 5 SHARRMALL		✓
EMISIONI I CO2	SISTEMI I MENAXHIMIT TË CO2 SIPAS PROTOKOLLIT WBCSD	✓	Përfshire në EMS ISO 14001
CILËSIA	ISO 9001		✓
MJEDISORE	ISO 14001		✓
MJEDISORE	IPPC		Draft Licenca e Pranuar
SIGURIA	ISO 18001 / OHSAS		✓
LLOGARIDHËNIA	SA 8000		Gradualisht në 2014
FINANCA	AUDITIMI VULLNETAR NË MES TË VITIT		✓
DNV	AUDITIM		✓



**KOSOVO
CSR
NETWORK**

Rrjeti i Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës (CSR) i Kosovës si rrjeti i parë i bizneseve i themeluar në Kosovë për CSR nga anëtarët themelues vazhdon punën e tij për të ngritur vetëdijesimin e publikut për CSR dhe gjithashtu përfshirjen e praktikave më të mira të CSR në kompanitë e tyre.

Edhe pse momentalisht një organizatë e vogël, rrjeti dëshiron të rritet dhe bëhet një rrjet stimules për të tërheq biznese të reja në promovimin e CSR në të gjithë Kosovën. Në ditët e para të tyre aty ishin 14 kompani anëtare mirëpo tani numri është rritur deri në 22 kompani anëtare të cilat e frymëzojnë rrjetin të vazhdojë në detyrat dhe sipërmarrjet e tyre.

Duke qenë anëtar i Rrjetit Evropian të Bizneseve për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatës (CSR Europe) është edhe një hap tjetër i integritimit të organizatave Kosovare në strukturat Evropiane.



Plani i Aksionit 2013-2014

Rrjeti ka prezantuar një plan të aksioneve për anëtarët e tij dhe zinxhirët furnizues të tyre. Plani merret me a) principet e Kompaktit Global për punën e fëmijëve dhe b) rregullat themelore të kontraktimit korrekt (dhe vetëdije kontraktuale), që ende janë qështje në Kosovë. Me këtë iniciativë rrjeti ka për qëllim të lansoj dhe shpreson të zgjerojë një listë gjatë të kompanive që përkushtohen të ndihmojnë zhdukjen e punës së fëmijëve dhe respektin për kontranta.

Misioni

Rrjeti i Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës (CSR) i Kosovës është organizatë jo-qeveritare, pa qëllim fitimi e themeluar nga anëtarët e tij për qëllimin e përkrahjes së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik duke fuqizuar praktikën më të mira të CSR në shoqëri dhe gjithashtu duke qenë në pajtim me principet e Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara.

Vizioni

Rrjeti CSR është i përkushtuar të përqafojë përgjegjësinë për veprat e kompanisë dhe inkurajimin për ndikim pozitiv përmes aktiviteteve tona mbi mjedis, konsumatorë, punëtorë, komunitete, hisedarë dhe publikun e gjerë.

Anëtarët e Rrjetit CSR të Kosovës:



Shëndeti dhe Siguria në Punë

Si një nga çështjet më të rëndësishme, sidomos duke pasur parasysh faktin që Sharrcem është një kompani e industrisë së rëndë, siguria vazhdon të jetë një nga fokuset kryesore të punës sonë të përditshme. Krijimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i një kulture të përgjegjshme të sigurisë, mbetet prioriteti më i latë i biznesit tonë.

Për të arritur këtë qëllim kompania vazhdon të mos kursejë asnjë resurs dhe vazhdon të investojë shuma në rritje në këtë drejtim, nga të cilat përfitojnë të gjithë aktorët tanë kryesorë duke përfshirë punonjësit tanë, kontraktuesit si dhe komunitetin në të cilin ne operojmë.

Disa nga investimet që ndikojnë në siguri të kryera në 2013 përfshijnë: trajtimin e ujit, reduktimin e zurmës, sistemi i vazhdueshëm i monitorimit të pluhurit, mbyllja e pjesës lindore të sallës për deponim të klinkerit, rehabilitimi i mullirit #1 të çimentos, kapakun mbulues, siguria në komunikacion etj. Kompania do të vazhdojë të zbatojë praktikatat më të mira dhe të zhvillojë mënyra të reja dhe të sofistikuara për përmirësimin e sigurisë së punonjësve tanë dhe hisedarëve tjerë të rëndësishëm.

Sharrcem ka kryer implementimin e Sistemit Menaxhues të Sigurisë OHSAS 18001 në 2013 dhe ka arritur certifikimin në Dhjetor të vitit 2013. Sharrcem vazhdon të trajtojë Sigurinë dhe Shëndetin si prioritet kryesor duke trajnuar secilin punonjës. Për këtë qëllim ne kemi zhvilluar programin trajnues e së Enjtes i cili


është i zbatuar nga Departamenti i Shëndetit dhe Sigurisë dhe vizitohet nga të gjithë punonjësit e kompanisë.



- **Trajnim i detyruar mësues për të gjithë personat që vizitojnë fabrikën.**
- **Krijimi i udhë rrëfimeve/procedurave emergjente për siguri në punë.**
- **Implementimi i (i) menaxhimit të vozitësve të kontraktuesve përmes trajnimit në punë, (ii) metoda të sigurta të punës, (iii) fillimin e njoftimit të udhëzimeve të WBCSD/CSI për siguri për kontraktues.**
- **Kontroll vjetore mjekësore për të gjithë personelin.**
- **Instalimi i sistemit të ri të ujitjes për të gjithë fabrikën.**
- **Instalimi i siguresave VCS përgjatë gjithë linjës së prodhimit.**
- **Instalimi i softuerit LOTO.**
- **Izolimi i kablove ndër-departamentale.**
- **Vlerësim 360 shkallësh i kompanisë.**
- **Programe për punonjës – Zhvillimi i një Kulture të Sigurisë.**
Në 2013 kompania ka caktuar një kontratë PPVS (Përfshirje për Përmirësimin e Vazhdueshëm e Sigurisë) për ofruesin specialist Management Group LLC Force me qëllim për të rritur kulturën operative të sigurisë; ky program i dedikuar i trajnimit krijon thelb të vazhdueshëm të ndjeshmërisë së përparuar në fushën e zbulimit e rreziqeve dhe praktikave të pasigurta në mes të punonjësve dhe ofron dijeni relevante për eliminimin e tyre. Ky program udhëhiqet në grupe të punonjësve të cilët bëhen agjentë të ndryshimit për përparimin e të gjithë fuqisë punëtore në aspekt të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. CCT1 është filluar në 2013 dhe ka bërë përparime të mëdha, përderisa CC2 do të fillojë në fillim të vitit 2014.
- **Progresi CSI**
Gjithashtu gjatë vitit kompania është angazhuar në pajtim me praktikatat më të mira të CSI sa i përket sigurisë në komunikacion dhe sigurisë së kontraktuesve. Një detyrë e madhe që kërkon revizione dhe rreshtime në një numër të madh të sistemeve të kompanisë (menaxhment i qasjes, prokurim dhe kontraktim, kërkesa të punës dhe planifikim), do ta mbajë kompaninë të angazhuar deri në 2015.

Performanca e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Personeli i Sharrcem është i detyruar për të monitoruar, regjistruar, dhe raportuar incidentet profesionale të shëndetit dhe sigurisë dhe kushtet në vendin e punës (të cilësisë së ajrit dhe parametrat fizike, të cilat ndikohen potencialisht nga proceset industriale) gjatë gjithë periudhës raportuese.



Pajtueshmëria në Kosovë

Asnjë inspektim nuk është kryer nga agjencia e punës lokale apo autoritete tjera përkatëse të shtetit në vitin 2013. Fabrika është e detyruar të njoftojë autoritetet e vetëm në rast të ndonjë aksidenti. Gjatë vitit 2013 nuk ka ndodhur asnjë aksident kështu që asnjë raport nuk është bërë tek autoritetet.

Monitorimi i Vendit të Punës

Gjatë vitit 2013 kompania Management Force (një konsulent i jashtëm) mori një projekt nga Sharrcem për të kryer matjet e pluhurit, zhurmës, ndriçimit, kimikateve dhe WBGT në pika të caktuara dhe vende të punës në fabrikë. Për të gjitha matjet ata ndajnë me ne:

- Detajet e metodologjive të aplikuara për të kryer matjet dhe pajisjet e përdorura për këtë qëllim.
- Rezultatet e matjeve.
- Sugjerime / propozime për përmirësimin e shëndetit dhe sigurinë dhe mbrojtjen e punonjësve.


PARAMETRAT E MONITORIMIT NË VENDE TË PUNËS	SHPESHTËSIA E MATJES	LIMITI MAKSIMAL I VLERAVE	PERFORMANCA E SHARRCEM
KONCENTRIMI FRYMË-MARRËS I AJRIT NË VEND TË PUNËS			
ASBEST (NËSE ËSHTË PREZENT)	ÇDO TREMUJOR	0.5 MG/M ³	JO PREZENT
KARBON MONOKSID	ÇDO TREMUJOR	40 MG/M ³	28.64 MG/M ³
NITROGEN OKSID	ÇDO TREMUJOR	6 MG/M ³	0.94 MG/M ³
PARTIKULA (INERTE APO PLUHUR) MAKSIMUM	ÇDO TREMUJOR	10 MG/M ³	17.39 MG/M ³
PARTIKULA (INERTE APO PLUHUR) MINIMUM	ÇDO TREMUJOR		0.05 MG/M ³
SILIKATE, KRISTALE (SI PLUHUR FRYMË MARRËS)	ÇDO TREMUJOR	0.1 MG/M ³	N/A
INDUSTRI E RËNDË (PA DETYRIM PËR KOMUNIKIM GOJORË)	ÇDO TREMUJOR	85 dB(A)	84,8 dB(A)
NIVELI MAKSIMAL I ZHURMËS			109,9 dB(A)
NIVELI MINIMAL I ZHURMËS			58,1 dB(A)

Tejkalimi i limiteve të pluhurit dhe zhurmës është regjistruar në vitin 2013. Sharrcem ka krijuar menjëherë planet e veprimit për përmirësim në këto dy fusha.

Rreth çështjes së shpeshtësisë së matjes: Gjatë 2013 Sharrcem bërë matjet përkatëse të pluhurit dhe zhurmës vetëm në një periudhë, në korrik. Plani për 2014 është për të kryer matje çdo tre muaj.

Rreth parametrave tjerë të monitorimit:

1. Azbesti: Asnjë burim i asbestit nuk është identifikuar kudo në fabrikë dhe për këtë arsye matje të tilla nuk janë kryer.
2. Partikulat: Matjet janë kryer.
3. Silikatet: Sharrcem është duke hetuar mundësinë e një laboratorit të certifikuar që mund të kryej matje të tilla, duke filluar në 2014.



Gjatë 2013 vetëm një (1) stërvitje zjarri është kryer, për shkak të deficitit të burimeve njerëzore dhe pajisjeve nga komunat vendore, si dhe nivelit të ulët të infrastrukturës së autoriteteve kompetente.

Sharrcem ka një plan për të kërkuar më tej burime brenda vendit (komunat larg nga Hanit të Elezit, por me qaske në kamionë dhe personel zjarrfikës), dhe rritjen e numrit të stërvitjeve kundër zjarrit në të paktën tri (3) në vit, duke filluar në 2014.

Aktivitetet e Sharrcem në lidhje me operacione të sigurisë kundër zjarrit

AKTIVITETET PËR VERIFIKIM TË SIGURISË KUNDËR ZJARRIT TITAN-DANUB	SHPESHTËSIA E DETYRUAR	DATAT KUR JANË KRYER	MANGËSITË E VËREJTURA	VEPRAT PËRMIRËSUESE DHE ORARI PËR IMPLEMENTIM
STËRVITJET E ZJARRIT	MINIMUM TRI (3) HERË NË VIT	PRILL 2013*	ASNJË	3 STËRVITJE TË PLANIFIKUARA PËR 2014.
INSPEKTIMI DHE CERTIFIKIMI I SISTEMEVË MEKANIKE DHE ELEKTRIKE PËR ZBULIMIN DHE NDALIMIN E ZJARRIT.	MINIMUM NJË (1) HERË NË VIT	MARS 2013	ASNJË	VAZHDIMI ME TË NJËJTIN ORAR SIKURSE 2013.
INSPEKTIMI DHE RIMBUSHJA E BOBOLEVË PËR FIKE TË ZJARRIT	MINIMUM (2) HERË NË VIT	PRILL 2013	NONE	CONTINUE WITH SAME SCHEDULE LIKE 2013.

Significant OH&S Events

- Scheduled audits (2 internal and 1 external) were performed according to the OH&S 18001. (Procedure page 11.)
- OH&S working instructions for significant activities (during routine and maintenance activities) are under development, in conformity with the recommendations of the Group 360° H&S Audit.
- Job descriptions for all levels are finalized.
- Medical checks of employees scheduled for 2013 (every 2 years) were performed.
- Improvement of lighting all around the plant.
- Certification of air tanks, hoists & personnel elevators is completed.
- An ATEX study at solid fuel line was performed and its recommendations were implemented.
- 103 VCS (Visible Cut-Off Switches) were installed, as part of the LOTO system.
- A new fire-fighting main line (1,122m long) and hydrants was installed.
- More than 1km hand rails, 500m² of safety platforms and ladders were installed.
- SharrCem effected implementation of the Safety Management System SMS ISO 18001 in 2013 and achieved certification in December of 2013.
- A digital system to accurately clear and record access and presence respectively of own and contractors' employees was installed in 2013 and linked to the EAM maintenance system. The latter has been appropriately configured to embed all job request and job permit procedures.




Trajnimet e Sigurisë dhe Shëndetit

Në këtë periudhë raportimi, janë mbajtur trajnimet e mëposhtme

	PËRSHKRIMI I TRAJNIMIT	NUMRI I PUNONJËSVE PËSËMARRËS
PUNONJËSIT E SHARRCEM	PUNA NË LARTËSI	14
	PUNA E NXEHTË	129
	PUNA E DORËS	26
	SIGURIA ELEKTRIKE	26
	LEJA E PUNËS	11
	PRERJA E OKSI-AKSELITENIT	82
	MJETET PERSONALE MBROJTËSE	299
	SIGURIA NË ZYRE	30
	THEMELORET E LUFTËS KUNDËR ZJARRIT	11
	LISTA E KONTROLLIT TË INSPEKTIMIT	25
	SINJALIZIMI ME DUAR I VINÇIT	10
	MATERIALET E RREZIKSHME	16
PUNONJËSIT E KONTRAKTUESVE	TAG-IN/TAG-OUT	171
	VLERËSIMI I RREZIKUT	7
	PETKOK	12
	PPE	32
	TRAJNIM I SKELAVE	6
	SIGURIA NË NGASJE TË MAKINAVE	20

Orët e Punës së Trajnimeve për Shëndet dhe Siguri



Punonjësit e Drejtpërdrejtë: Punonjësit e Jo-drejtpërdrejtë:



Incidentet pa Lëndime

- ✓ Të hetuara plotësisht
- ✓ Vetëdijesimi përmes trajnimeve



Incidentet pa Lëndime

INCIDENTET PA LËNDIME (TË PUNËSUAR NË MËNYRË TË DREJTPËRDRREJTË)	27
NUMRI I INCIDENTEVE PA LËNDIME (TË PUNËSUAR NË MËNYRË TË JO-DREJTPËRDRREJTË)	15
NUMRI TOTAL I INCIDENTEVE PA LËNDIME (TË PUNËSUAR NË TË DY MËNYRAT)	42
NUMRI TOTAL I INCIDENTEVE PA LËNDIME TË HETUARA NË MËNYRË TË DUHUR	42
NUMRI I VEPRAVE KORRIGJUESE TË BËRA NË BAZË TË TË GJITHË INCIDENTEVE PA LËNDIM	42

IKP (Indekset Kyçe të Performancës)	2010	2011	2012	2013
LKH (LËNDIMET ME KOHË TË HUMBUR) SHPESHTËSIA PËR PUNONJËS DIREKT	0	0	0	0
LKH (LËNDIMET ME KOHË TË HUMBUR) SHKALLA PËR PUNONJËS DIREKT	0	0	0	0
LKH (LËNDIMET ME KOHË TË HUMBUR) SHPESHTËSIA PËR PUNONJËS INDIREKT	0	1	0	0






Njerëzit Tanë

Duke qenë një nga hisedarët më të rëndësishëm, fuqia e jonë punëtore është gjithmonë në ballë të të vendimmarrjes sonë. Si rezultat i kësaj praktike kompania vazhdon të investojë shumë në përmirësimin e kulturës së sigurisë jo vetëm në kuadër të kompanisë, por edhe përmes zinxhirit tonë të furnizimit.


Përveç që kujdesemi për sigurinë e punonjësve tanë ne gjithashtu duam të sigurojmë mirëqenien e tyre, si dhe zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Duke qenë kështu kompania ka nisur negociatat me kompanitë e sigurimeve për të siguruar punonjësit tanë dhe familjet e tyre me sigurimin shëndetësor për të siguruar që ata kanë qasje në kujdes të mirë shëndetësor.

Duke konsideruar arsimin si një nga shtyllat e zhvillimit personal dhe profesional kompania ka vazhduar të mbështesë zhvillimin e punonjësve tanë në 2013 përmes bursave, rimbursimit të shkollimit, trajnimeve të ndryshme etj. Duke lëvizur përpara kompania do të vazhdojë të rrisë këto angazhime për të siguruar zhvillim të sigurt dhe të shëndetshëm të fuqisë tonë punëtore e cila është shtylla kryesore e kompanisë sonë.

Orët e Trajnimeve



Punonjësit Anëtar të Sindikatës së Pavarur (mesatarja 2013)



Politikat dhe Procedurat

POLICIES AND PROCEDURES 2013 – EC6	KOSOVË
QËSHTJET E TË DREJTAVE NJERËZORE	SA 8000, PËRGATITUR (SHIH FAQET 12 DHE 18)
TË DREJTAT E PUNËS DHE LIRIA ASOCIIMIT	SA 8000, PËRGATITUR (SHIH FAQET 12 DHE 18)
MUNDËSITË E BARABARTA	SA 8000, PËRGATITUR (SHIH FAQET 12 DHE 18)
SPONZORIMI, DONACIONET DHE ANGAZHIMI NË KOMUNITET	DY MARRËVESHJE AKTIVE/FONDACIONI
ZINXHIRI FURNIZUES/PROKURIMI	CoCP I GRUPIT
PREFERENCA PËR FURNITOR LOKAL	✓
PREFERENCA PËR QYTETAR LOKAL PËR PUNËSIM	✓
PUNËSIMI I KONTRAKTUESVE LOKAL	✓
KOPIJA E DORACAKUT TË GRUPIT PËR PROKURIM	✓
TË PUNËSUAR TË RI 2013	4 (PREJ TË CILËVE 2 LOKAL, 1 KOMBËTAR DHE 1 EMIGRANT)
DORËHEQJE 2013	6
ASSIGNMENT EXPIRED / 2013	3 EMIGRANT

PËRFITIMET E PUNONJËSVE ME ORAR TË PLOTË		2012	2013
KONTROLL SHËNDËTËSOR		Po	Po
SIGURIM NË PUNË		Po	Po
DHURATA	PËR FESTA FETARE PËR DITËN E GRUAS PËR VIT TË RI	Po Po Po	Po Po Po
ARSIM	MASTER NË BIZNES KURSE TË ANGLESHTES KONFERENCA	5 3 12/15 MENAXHERË	4 4 10/17 MENAXHERË
SINDIKATA	KONTRIBUTI I RREGULLT 50% KONTRIBUT DIREKT I JASHTZAKONSHËM	Po Po	Po Po
KOMUNIKIMI	LISTAT E FAKTEVE STENDË AFSHIMI KUTITË E PROPOZIMEVE	Po Po Po	Po Po Po

Kontrolli Shëndetësor

Duke vazhduar shërbimet tona tradicionale të kujdesit shëndetësor për të punësuarit tanë, Sharrcem organizoi edhe një kontroll vjetor mjekësor për të siguruar që të gjithë punonjësit tanë kanë përfunduar një ekzaminim të plotë për të siguruar që shëndeti i tyre është i mbrojtur. Ne besojmë që ky lloj i kujdesit parandalues krijon platformë për të parashikuar ndonjë çështje të fshehur shëndetësore dhe për të siguruar që të punësuarit janë të vetëdijshëm për gjendjen e tyre dhe për të marrë kujdes më të mirë për shëndetin e tyre. Ne gjithashtu do të vazhdojmë të punësojmë mjekun me orar të plotë në lokalet tona që ofron kujdesin parësor

dhe shërbime të ndihmës së parë për të gjithë të punësuarit tanë. Për të zgjeruar kujdesin për shëndetin e punonjësve tanë, Sharrcem ka nisur negociatat me ofrues të sigurimit shëndetësor në mënyrë që të mund të sigurojmë mbulim të mirë shëndetësor për të gjithë punonjësit tanë dhe bashkëshortët e tyre.

Donacioni i Gjakut

Me 13 Qershor të 2013, sikurse edhe në të kaluarën, Sharrcem ka vazhduar organizimin e donacionit të gjakut. Këtë vit ne kemi pasur 54 donator prej të cilëve 48 ishin meshkuj ndërsa 6 ishin femra.

S edhe më parë edhe sivjet atyre ju ka siguruar një shujte në mensën tonë.

2012

39 Donator

30 prej vitit të kaluar
31 meshkuj
8 femra

2013

54 Donator

39 prej vitit të kaluar
48 meshkuj
6 femra


Punonjës për Kategori

Menaxherë Senior	6
Menaxherë	12
Administratorë/Teknik	73
Punë e Gjysmë shkathtë/ E Pa shkathtë	404

Struktura Gjinore

	2012	2013
 Meshkuj	484	478
 Femra	18	19

Punonjësit në Sharrcem/Kompani e Grupit Titan




EPunonjësit në Sharrcem/Kompani e Grupit Titan	2012	2013
Numri i të punësuarve me orar të plotë	502	497
Numri i punonjësve afat shkurtë	0	0
Numri total i punonjësve	502	497
Numri i punonjësve me gjini	%	%
 Femra	3,6	3,8
 Meshkuj	96,4	96,

Rrogat Mujore

	KOSOVË	SHARRCEM	
MINIMUM	130 – 171.6 € (1)	350 €	(1) BANKA BOTËRORE
MESATARE	400 – 450 € (2)	790 €	(2) PËRLLQARITJE E KOMPANISË

Menaxhmenti Lokal / Bordi i Zgjeruar Menaxhues



Angazhimi me Hisedarë

Në 2013, departamenti i proceseve të prokurimit është integruar plotësisht në sistemin EAM të kompanisë. Në këtë mënyrë kontraktuesit dhe kontratat e furnizuesit janë të regjistruara siç duhet dhe të plotësuara me të gjitha kauzat e sigurisë dhe pikëve të qasjes të cilat janë të detyrueshme nga kompania. Regjistrat e veçantë ekzistojnë edhe për kontraktuesit

e veçantë, të miratuar dhe të mbajtur nga menaxhmenti teknik i fabrikës, si dhe për të gjitha shërbimet që janë të ofruara në gjendjen e urgjencës për të cilat një regjistër i detajuar është mbajtur me një miratim pas datës së kryerjes së shërbimit. Për më tepër, në sajë të integritetit të lartpërmendur, kompania është përshtatur plotësisht me procedurat e Grupit dhe tani kontrollon dhe regjistron të gjithë spektrin e marrëdhënieve me furnizues dhe kontraktues.

Iniciativa për Çimento të Qëndrueshëm (CSI) – Adaptim i Udhëzimeve

